



BASHKIA
TIRANË

277

Nr.Prot. 1372/4

13.3 2017

KONTRATË SHËRBIMI


OBJEKTI

**“LINEARIZIMI FINANCIAR NË INSTITUCIONET E VARËSISË TË BASHKISË
TIRANË”**

TIRANË

2017

Adresa: Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, 1001, Tiranë, Shqipëri, Tel:



KONTRATË SHËRBIMI

“Linearizimi financiar në institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë”.

Lidhur sot më datë _____ 2017 në bazë të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, midis:

Bashkisë së Tiranës, e përfaqësuar nga **Z. Erion Veliqaj**, Kryetar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me adresë: Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet **“Autoriteti Kontraktor”**;

Dhe

Shoqërisë **“Communication Progress”** shpk në cilësinë e Kontraktuesit, regjistruar si person juridik me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr. 20351, datë 25.11.1998, me seli të shoqërisë: Rruga; “Dritan Hoxha”, Pallati MC Inerte, Njesia Bashkiake Nr 7, Tiranë, me Nr. NUIS të shoqërisë: K01625001C, përfaqësuar nga **Z. Gentian Likaj**, Përfaqësuesi Ligjor, i mëposhtëquajtur **“Kontraktor”**.

Neni 1

Baza Ligjore

- 1.1 Kjo kontratë mbështetet në Kodin Civil të R.SH, dhe në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe akteve nënligjore të nxjerrë në zbatim të tij.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit të procedurës për Prokurim me Objekt **“Linearizimi financiar në institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë”**, duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 **“Cmim kontrate”** do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 **“Objekt i kontratës”** do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 **“Palë (t)”** do të thotë nënshkruarit e kontratës.
- 2.5 **“Autoriteti Kontraktor”** do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 2.6 **“Kontraktues”** do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.



- 046
- 2.7 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 "Termat e References" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- 2.9 "Llogaritja e Afateve" Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.
- 2.10 "Preventivi" quhen vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e kontratës.

Neni 3

Objekti i Kontratës

- 3.1 Objekti i kësaj kontrate është "Linearizimi financiar në institucionet e varësisë të Bashkisë Tiranë".

Neni 4

Afati i Kontratës

- 4.1 Afati i kryerjes së shërbimit për implementimin e projektit është 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga data e lidhjes së kontratës.
- 4.2 Periudha e mirëmbajtjes së këtij sistemi do të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të tij pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore prej 4 (katër) vjet.
- 4.3 Garancia e sistemit dhe pajisjeve hardëare është jo më pak se një vit nga data e marrjes në dorëzim të sistemit.
- 4.4 Kontrata hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët, kohë në të cilën Kontraktuesi fillon punën menjëherë nga ku nisin edhe efektet e saj teknike ligjore dhe financiare.
- 4.5 Linearizimi i menaxhimit financiar, produkt i cili do të jetë në funksion të rritjes së performancës që institucionet e varësisë të arrijnë më shumë rezultate me buxhete të reduktuara dhe të eliminojnë vështirësitë që ekzistojnë për koordinimin dhe menaxhimin e informacionit financiar duhet të plotësojë të gjitha termat e referencës të kërkuara nga Bashkia e Tiranës dhe ato të paraqitura në ofertë nga shoqëria "Communication Progress" sh.p.k. Dokumentacioni i tenderit si dhe oferta e shoqërisë "Communication Progress" sh.p.k është pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj kontrate.

Neni 5

Çmimi i Kontratës

- 5.1 Çmimi total i kontratës është 48.477.600 (dyzet e tetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë me TVSH, i cili është çmimi i ofruar në ofertën e shoqërisë "Communication Progress" shpk dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës.



Neni 6

Preventivi i Shërbimeve

6.1 Vlerësimi i zërave të shërbimit do të kryhet në bazë të preventivit të ofertës të paraqitur në tender nga Kontraktuesi për zërat e përcaktuara si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Cmimi/njësi	Cmimi total
1.	Linearizimi financiar ne Institucionet e Varesise te Bashkisë Tiranë (zhvillim sistemi, trajnim, instalim)	1	21.700.000	21.700.000
2.	Mirëmbajtje vjetore (për katër vjet)	4	3.830.000	15.320.000
3.	Infrastruktura hardëare per hostim (furnizim, instalim)	1	2.810.000	2.810.000
4.	Mirëmbajtje lokale e infrastrukturës hardëare (për katër vjet)	4	142.000	568.000
	Totali pa TVSH			40.398.000
	TVSH (20%)			8.079.600
	TOTALI ME TVSH (LEKË)			48.477.600

Neni 7

Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 7.1 Bashkia e Tiranës mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 7.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 7.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Bashkinë e Tiranës të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Bashkia e Tiranës

Neni 8

Informacioni Konfidencial

8.1 Kontraktuesi dhe Bashkia e Tiranës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.



Neni 9

Prona Intelektuale

- 9.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 9.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 10

Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 10.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuar ne përgjithësi.
- 10.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 10.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Bashkisë Tiranë, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 10.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqësimin e Autoritetit Kontraktues.



Neni 11

Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 11.1 Kontraktuesi bie dakord të kryejë shërbimin objekt i kësaj kontrate, bazuar në zërat e shërbimit të përcaktuar në Preventiv si dhe në përputhje me "Termet e referencës", grafikun e miratuar për kryerjen e shërbimeve të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 11.2 Kontraktuesi është i detyruar të realizojë shërbimin e marrë përsipër në përputhje të plotë me dokumentat e tenderit, termat e referencës dhe grafikun e shërbimeve pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- 11.3 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Bashkisë Tiranë të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 11.4 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 12

Specifikime dhe Skicime

- 12.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Bashkinë Tiranë dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 12.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjëse përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 13


Lejet dhe Liçensat

- 13.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 14

Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 14.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë trajtim për të gjithë të punësuarit e tij në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të R.SH.
- 14.2 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 14.3 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.



- 280
- 14.4 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 14.5 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.
- 14.6 Projekti do të menaxhohet nëpërmjet këtyre njësive kryesore në tre nivele:
- a). **Financuesit e projektit:** Janë perfaqesues të FZHR dhe Bashkisë Tiranë të cilët monitorojnë realizimin e projektit dhe arrijtjen e objektivave të tij.
- b). **Menaxheri i projektit:** Kontraktori është i detyruar të çaktojë një menaxher projekti. Menaxheri i projektit është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Menaxheri i projektit është: **Z. Dhimitër Shuli**. Detyrat e Menaxherit të projektit janë si më poshtë:
- Të menaxhojë zbatimin e shërbimit për implementimin e projektit konform kontratës; të garantojë burimet e nevojshme për realizimin e projektit nga të dy palët dhe kanë vendimmarrjen kryesore në kuadrin e projektit, të koordinojë ekipet e punës dhe përshkallëzojë çështje tek financuesit e projektit.
 - Të mbaje dokumentacionin përkatës teknik që është i detyrueshëm të mbahet gjatë kryerjes së shërbimit;
 - Të ndjekë ecurinë e shërbimit konform plan organizimit dhe grafikut të shërbimit;
- c). **Ekipet e punës:** Staf i specializuar nga të gjitha palët e përfshira përbëjnë këto ekipe. Rolet dhe përgjegjësitë janë të ndara për çdo anëtar të ekipit dhe komunikimi midis ekipeve koordinohet nëpërmjet menaxherit të projektit.

- 14.7 Në rast se ndryshohet Menaxheri i Projektit, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë me shkrim Autoritetin Kontraktor.

Menaxheri i Projektit në këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Menaxher Projekt. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e tij nëse vlereson se ai nuk përmbush kualifikimet e përcaktuara në Dokumentat e tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një menaxher projekti tjetër dhe detyrimisht lajmëron Autoritetin Kontraktor.

Neni 15

Vendndodhja

- 15.1 Shërbimi do të realizohet pranë: **Godinës qendrore: Bashkia Tiranë, Sheshi "SKËNDERBEJ", Nd. 2, Kodi postar 1001;**
- 15.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.



281

Neni 16

Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 16.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Bashkinë Tiranë për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 16.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën minimale të njohur në përgjithësi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen

Neni 17

Taksat

- 17.1 Kontraktuesi është i detyruar të paguaj të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 18

Kërkesat e Raportimit

- 18.1 Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në original në 3 kopje, nga të cilat 2 kopje për Bashkinë Tiranë dhe një kopje për kontraktuesin:

- **Raporte sipas fazave/afateve të projektit** - Kontraktuesi duhet të paraqesë raporte për çdo fazë të realizimit të projektit, sipas afateve kohore në përputhje me **Planin e realizimeve dhe dorëzimeve bashkëngjitur kesaj kontrate**, duke pasqyruar të gjithë procesin e ndjekur dhe realizuar.
Raportet sipas fazave/afateve të projektit duhet të shoqërohen me dokumentacion justifikues dhe faturat tatimore përkatëse.
Dokumentacioni sa me sipër cituar duhet të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe duhet të miratohet prej saj jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e lëshimit të tij.
Në rast se përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor nuk shprehin kundërshtime brenda afatit 5 (pese) ditor, Raportet dhe Faturat Tatimore do të konsiderohen automatikisht të pranuar nga Autoriteti Kontraktor.
- **Raporti final** - Kontraktuesi duhet të paraqesë Raportin Final me marrjen në dorëzim të sistemit dhe në përputhje me **Planin e realizimeve dhe dorëzimeve bashkëngjitur kesaj kontrate**.
Raporti final duhet të shoqërohet me dokumentacion justifikues dhe faturën tatimore përkatëse.
Dokumentacioni sa me sipër cituar duhet të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe duhet të miratohet prej saj jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e lëshimit të tij.
Në rast se përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor nuk shprehin kundërshtime



282

brenda afatit 5(pese) ditor, Raporti dhe Fatura Tatimore do te quhen automatikisht te pranuar nga Autoriteti Kontraktor.

- **Raport mirembajtje** - Kontraktuesi duhet të paraqesë Raportin 3-mujor per kryerjen e shërbimeve te mirembajtjes te shoqeruar me dokumentacion justifikues dhe me faturen tatimore perkatese.
Dokumentacioni sa me siper cituar duhet te dorezohet prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane dhe duhet te miratohet prej saj jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e lëshimit te tij.
Ne rast se perfaqesuesit e Autoritetit Kontraktor nuk shprehin kundërshtime brenda afatit 5 (pese) ditor, Raporti dhe Fatura Tatimore do te konsiderohen automatikisht te pranuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 19.

Marrja në dorëzim e shërbimit

- 19.1 Autoriteti Kontraktor do të ngrejë një komision të posaçëm për marrjen ne dorezim ne menyre pjesore dhe perfundimtare te projektit te realizuar bazuar në **Planin e realizimeve dhe dorëzimeve**, si dhe fazave të financimit referuar grafikut të financimit sipas VKM Nr. 38 dt 13.07.2016 për "Shpërndarjen e financimit për projekte të reja, nga granti "Shqipëria Dixhitale", në programin e Infrastukturës Vendore dhe Rajonale" si dhe nga Buxheti i Bashkisë Tiranë me anë të VKB-së Nr 59 dt 25.07.2016 për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr.58, datë 30.12.2015 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2016".
- 19.2 Komisioni i marrjes ne dorezim te shërbimit do te perbehet nga nje staf i specializuar pranë Drejtorisë së IT-së , Bashkia Tiranë.
- 19.3 Komisioni i marrjes ne dorezim do te hartoje proces verbalet pjesore te marrjes ne dorezim te shërbimit referuar raporteve, dokumentacionit justifikues dhe faturat tatimore si percaktohet ne Nenin 18 të kësaj kontrate.
- 19.4 Komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të shërbimit të kryer, me përfundimin total të implementimit të këtij projekti, do të hartojë një procesverbal përfundimtar të marrjes në dorëzim të të gjitha shërbimeve të kryera sipas preventivit bashkangjitur kësaj kontrate.Data e marrjes në dorëzim të shërbimeve të kryera do të konsiderohet edhe data e fillimit të mirëmbajtjes së këtij sistemi sikundër referohet në nenin 4 pika 4.2 e saj.

Neni 20.

Mirëmbajtja e sistemit

- 20.1 Periudha e mirëmbajtjes së këtij sistemi do të fillojë nga data e marrjes në dorëzim të tij pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore prej 4 (katër) vjet, bazuar në VKM Nr 710 dt 21.08.2013 për "Krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".



- 20.2 Gjatë periudhës së mirëmbajtjes kontraktori është i detyruar të zbatojë "Marreveshjen mbi nivelet e shërbimit të ofruara nga suporti teknik" bashkalidhur kësaj kontrate. Në rast se autoriteti kontraktor nuk paraqet asnjë kërkesë për suport teknik kontraktuesi do të realizojë një kontroll periodik mujor për funksionimin e sistemit.
- 20.3 Raportet, dokumentacioni justifikues dhe faturat do të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë për likuidimin e shërbimit të kryer sipas përcaktimit të bërë në nenin 20 të kësaj kontrate .

Neni 21 Kushtet e Pagesës

- 21.1 Pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare (lekë). Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 21.2 Pagesa duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:
- Pagesa e faturave tatimore për fazat e implementimit të projektit do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e pranimit të shërbimeve dhe firmosjes së faturave tatimore. Në kushtet që lëvrimet e shërbimeve do të bëhen pjesore, Autoriteti Kontraktor pranon që pagesat të kryhen në mënyrë pjesore për vlerën e shërbimeve të lëvuara, për të cilën palët bien dakord, sipas faturave tatimore përkatëse.
 - Pagesa për shërbimet e mirëmbajtjes do të bëhet brenda 30 ditëve, pas dorëzimit të çdo raporti 3- mujor tek Autoriteti Kontraktor (Bashkia Tirane) së bashku me faturën tatimore 3-mujore sipas çmimit të përcaktuar në Formularin e Ofertës.
 - Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë (Komisioni i marrjes në dorëzim-IT) do të mbajë një procesverbal për shërbimin e kryer gjatë periudhës 3- mujore ku do të detajohen të gjitha shërbimet e mirëmbajtjes. Konfirmimi nga të dyja palët kontraktuese i procesverbalit të mbajtur nga ana e Autoritetit Kontraktor legjitimon pagesën e faturës tatimore përkatëse për këtë lloj shërbimi për periudhën 3- mujore të kryerjes së tij.
 - **Të dhënat e llogarisë së Kontraktuesit: Communication Progres Shpk**
Banka Intesa SanPaolo
Nr. llogarie: AL4220811008000020133535301 (LEK)
- 21.3 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 22 Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 22.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë përtej afateve të parashikuara në nenin 21, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përçindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.



- 22.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) te provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 23

Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 23.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

Për implementimin e projektit do të jetë:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.


Për periudhën 4 (katër) vjecare të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë:

- b) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 24

Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 24.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 24.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të shperblim për dëmet e shkaktuara për shkak të vonesës në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 24.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japë kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 24.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 24.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.



Neni 25

Ndryshimi i porosisë

- 25.1 Autoriteti kontraktor rezervon te drejtën e porosisë shtesë deri në një sasi që nuk kalon 20% të cmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregulla dhe mënyra të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.
- 25.2 Nevoja për volume shtesë përcaktohet nga Autoriteti Kontraktor (Bashkia) e cila identifikon volumet shtesë të cilat nevojiten të kryhen në vazhdim të kontratës.

Neni 26

Forca Madhore

- 26.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa nëzbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë sirezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 26.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 26.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 27


Garancia e kontratës

- 27.1 Garancia e kontratës do të jetë në masën 10 % të vlerës totale të kontratës të llogaritur në bazë të preventivit total të ofruar nga shoqëria fituese dhe konkretisht në vlerën 4.847.760 (katër milion e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë me tvsh.
- 27.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 27.3 *Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së perfundimit të plotë të kontrates.*

Neni 28

Klauzolë shtesë

- 28.1 Kushtet dhe termat e kësaj kontrate nuk mund të ndryshohen ose modifikohen përveçse me vullnetin e palëve.



Neni 29

Legjislacioni

29.1 Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

Neni 30

Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

30.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 31

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

31.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

31.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 32

Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

32.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

32.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.


32.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 33

Ndërprerja për Mosplotësim

33.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

33.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.



257

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 34.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrvshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrvshje me negociata direkte.
- 34.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrvshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrvshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 35

Të ndryshme

- 35.1 Kjo Kontrate do të hyje në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe mund të ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim nga të dy Palët.
- 35.2 Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 35.3 Kjo Kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje, ku 4 (katër) kopje janë për Autoritetin Kontraktor dhe nga 1 (një) kopje për Kontraktuesin. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.
- 35.4 Kësaj Kontrate i bashkëngjitet:
 - Propozimi Teknik
 - Marrvshja mbi nivelet e shërbimit të ofruara nga suporti teknik
 - Formulari i Ofertes

KONTRAKTUESI

AUTORITETI KONTRAKTOR

"COMMUNICATION PROGRESS" SH.P.K

BASHKIA E TIRANËS

**PËRFAQËSUESI I G.J.O.P
GENTIAN LIKAC**

**KRYETARI
ERION VELIAJ**

